

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Hagës, Martens: UÇK-ja nuk lindi nga asgjëja, nuk duhet të humbasim gjykimin historik
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/vendimi-i-hages-martens-uk-ja-nuk-lindi-nga-asgjeja-nuk-duhet-te-humbasim-i104558
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 20:49:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	45a1677663d494c53662656739b642282cbb8377763fd75ba07f0f6bd512127e
TEKSTI	286722d0f9f050ba1ec6fadd433475fc72222e8a865157384936b511b262b45f
PAMJA	f85d535e0a421eedfd99ae1422bd766a1d9f97d23895cb2fa5898a3014402457

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	78a1a978223c30a15d3cae7b8541d53c3dc61efb3975dcc8e1e69a46c0b05103
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcbf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/78a1a978223c30a15d3cae7b8541d53c3dc61efb3975dcc8e1e69a46c0b05103>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **Fier, ja akuzat që** të Prokurorisë Fier në **për krerët e** paralajmëruar se do të apelojnë... **Çuna nuk jeni vetëm!** rrugën "Mine Peza", ku **bulevard! Ne do e** gjatë rrugës së mbajtur në takimin e zhvilluar nga **thërret t'i japim** pjesë në Kuvendin e degës së Kështjës Çlirë

KOSOVA

Vendimi i Hagës, Martens: UÇK-ja nuk lindi nga asgjëja, nuk duhet të humbasim gjykimin historik

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 22:36



Gazetari i njohur i Frankfurter Allgemeine Zeitung, Michael Martens, ka komentuar vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-drejtimesve të UÇK-së, duke bërë një ndarje mes përgjegjësisë penale për krimet e trajtuara në proces dhe rolit historik që, sipas tij, ka pasur UÇK-ja në luftën e Kosovës.

Në një intervistë në SYRI TV Martens tha se vendimi i sotëm është vetëm i shkallës së parë dhe se duhet pritur edhe procesi i apelit. Megjithatë, ai vlerësoi se nga përmbledhja e vendimit të lexuar në Hagë, prokuroria kishte argumentuar çështjen e saj, ndërsa mbrojtja nuk kishte arritur të bindte trupin gjyqësor.

Pjesë nga intervista:

Armela Ferko: Sonte kam të ftuar gazetarin Michael Martens i Frankfurter Allgemeine Zeitung, por sigurisht edhe një njohës shumë i mirë i Kosovës, i historisë së Kosovës, i historisë së luftës dhe vazhdimisht e ka ndjekur këtë çështje, vazhdimisht ka ndjekur procesin, ka pasur intervistë madje me zotin Thaçi aty ku ai ka qëndruar deri më tani pra tek dhomat e specializuara të Hagës dhe ka pasur edhe përgjatë këtyre ditëve të fundit shkrime të ndryshme që lidhen me procesin, elementë të tij. Do të ndalemi tani që jemi disa orë pas vendimit. Do duhet dhe vendimi i apelit, por gjithsesi kemi një vendim nga Haga. Ndjeshë që u zgjata, përshëndetje dhe mirë se vini. Kënaqësi t'ju kem zoti Martens.

Michael Martens: Mirëmbrema dhe faleminderit për ftesën.

Armela Ferko: Kjo ishte më shumë për të dhënë një informacion për publikun mbi, le të themi, dhe rrethanat që kanë sjellë deri tek kjo intervistë e sotme. Tani, unë ju kam ndjekur me shumë vëmendje në të gjitha shkrimet tuaja po dhe opinionet që ju shkruani sigurisht në rrjetin social X më së shumti. Përpara se t'ju pyes për elementë shumë specifikë që më janë dukur shumë interesantë në këndvështrimin tuaj sidomos këto ditët e fundit, do të doja një opinion të përgjithshëm tuajin mbi këtë vendim të sotëm, edhe pse e di shumë mirë që do të thoni nuk ka një vendim të apelit pra ky nuk është një vendim përfundimtar. Por me kaq sa kemi, le ta themi, në Shqipëri, në Kosovë askush nuk priste të kishte këtë lloj vendimi me 25 vite burg për liderët e UÇK-së, për dy prej tyre, me të tjerët pastaj 18 dhe 13.

Michael Martens: As unë nuk e dija se çfarë të prisja. Jam përpjekur edhe unë që t'i ndjek këto procedime gjatë viteve. Sikurse e përmendët edhe ju kam intervistuar zotin Thaçi në burg edhe më përpara kur ishte ende pjesë e politikës si president i Kosovës edhe më përpara në pozicione të tjera. Jam përpjekur që ta ndjek si ngjarje por absolutisht nuk kisha asnjë lloj pritshmërie apo ndonjë të dhënë se ku mund të çonte i gjithë ky gjykim. Sikurse thotë dhe ju, është një vendim i shkallës së parë, do të shohim se çfarë do të dalë nga procedimet në shkallën e apelit. Në përgjithësi në këndvështrimin e ditës së sotme, them se duhet të studiojmë me kujdes që të gjithë vendimin, akoma nuk është publikuar, do të dojë një periudhë kohe që të publikohet, ne dimë vetëm përmbledhjen që u lexua sot nga gjyqtari Smith. Në bazë të asaj që dëgjuaam nga përmbledhja, mund të them se prokuroria, akuzat argumentoi mirë çështjen e vet dhe avokatët mbrojtës nuk arritën që të bindin gjyqtarët se krimet që ndodhën në Kosovë nuk ishin të lidhura me katër personat e akuzuar.

Armela Ferko: Kjo është aspekti i ftohtë dhe i drejtpërdrejt ose i pari i kësaj çështjeje. Ka disa mënyra se si të shihet. Ju e thotë, do të kemi rastin të analizojmë. Një pjesë e madhe sigurisht e hapësirës e marr debati juridik, lidhur me ngritjen e akuzave, provat ose provimin e tyre e të tjerë. Ndërkohë që gjithë pjesën tjetër dhe më të rëndësishme dhe që ka ngjallur më shumë debat është elementi politik i kësaj çështjeje. Pra, nëse sot shihen në mediat ndërkombëtare tituj të llojit që komandanti i UÇK-së, për zotin Thaçi në këtë rast, dënohet për krime lufte. A nuk është kjo një pasojë gjithësi e drejtpërdrejtë për luftën e UÇK-së?

Michael Martens: Nuk e kam lexuar CNN dhe nuk e di se çfarë është shkruar sepse nuk kam lexuar dot se çfarë kanë shkruar mediat e tjera sepse kam qenë i zënë duke u prononcuar vetë për këtë çështje. Për sa i përket mendimit tim, do të përsëris atë që shkruajta sot tek gazeta ime sikurse edhe në formatin e shtypur edhe në formatin online të gazetës. Fakti që krimet e tmerrshme kanë ndodhur duhet të pranohet si fakt, por në të njëjtën kohë ne nuk duhet të humbasim gjykimin historik. UÇK-ja nuk lindi nga asgjëja. UÇK-ja ishte një reagim, ishte një reagim ndaj viteve keqtrajtimi të shqiptarëve të Kosovës në vendin e tyre. Nuk u krijua për shkak të shqiptarëve dhe nuk ishte UÇK-ja ajo e cila e shkaktoi këtë konflikt i cili ngjalli luftën e viteve 98-99. Konfliktin e nisi qeveria e Sllobodan Millosheviçit në vitet '80, e cila e tërhoqi autonominë e Kosovës që kishte në Jugosllavi dhe kështu dolën një sërë ngjarjesh të cilat kulmuan pas 10 vitesh në një luftë dhe Serbia e kishte humbur Kosovën jo vetëm në aspektin territorial edhe de facto, por edhe moralisht. Besoj se këto dy fakte nuk janë në kundërshtim të njëra-tjetrës. Ka krime të cilat janë kryer nga persona individualë të UÇK-së, ne i kemi dëgjuar detajet për këtë dhe kanë qenë krime të tmerrshme. Por në të njëjtën kohë nuk duhet të nënvlerësohet roli historik i UÇK-së që luftoi për pavarësinë e Kosovës, që është e ftuar dhe që nuk mund të mohohet dhe asnjë gjyqtar nuk mund ta rrezojë.

Armela Ferko: Pikërisht kv është thelbi. ose të daktën kio është aio dilema që unë kam dasur përrejtë gjithë këtti procesi do e kam dasur dhe sot zoti Martens. Titulli që unë përmenta është i botuar

nga media prestigjioze ndërkombëtare CNN... Æ mund të ndahet në fakt njëri aspekt i historisë nga tjetri? Pra a mund të ndahet historia personale e Hashim Thaçit apo e komandantëve të tjerë të UÇK-së, nga narrativa historike e luftës së UÇK-së? Apo rrezikon që këto të dyja të mbërthehen me njëra-tjetrën ose të gërshetohen me njëra-tjetrën në një moment si ky dhe të përdoren nga Serbia. Po përdoren në fakt, Ivica Daçiç ka dalë sot e ka thënë që ja kjo është ajo çfarë ne kemi thënë për kaq vite.

Michael Martens: Ju thashë se nuk e dija se çfarë vendimi të prisja, por e dija 100% se çfarë do të thoshte...

Armela Ferko: Një moment, a mund ta ndërpresim një moment? Një moment, ja vetëm për t'jua treguar, për çështje transparence, për këtë titull isha duke folur kur thashë që, Haga ka dënuar ish-presidentin e Kosovës Hashim Thaçi për krime lufte. Ndjesë, mund ta vazhdoni logjikën tuaj.

Michael Martens: Pra fillova të thoja se nuk është se nuk e dija se çfarë do të dilte nga gjykimi sot. Disa persona më kanë telefonuar dhe u thashë se asgjë nuk do të më habisë. Por ajo çka dija dhe nuk ka pse të jesh shumë i mençur për ta kuptuar këtë, ishte reagimi i Beogradit dhe i Moskës. Hashim Thaçi dhe tre personat e tjerë po të ishin shpallur të pafajshëm do të kishin thënë që perëndimi është një parodi e vërtetë, është një parodi e drejtësisë nuk mund të merret seriozisht. Kurse në rastin tjetër që e pamë konkretisht sot, ishte e qartë që Moska dhe Beogradi do të thoshte se kjo vërteton se Hashim Thaçi është kriminel lufte kështu që perëndimi në '99-ën ka bashkëpunuar me një kriminel lufte. Ne nuk e dimë se çfarë do të ndodhë me procedimin gjatë apelit megjithëse e kam një përshtypje se do të jetë e vështurë që të rrëzohet vendimi i sotëm. Por edhe sikur Hashim Thaçi dhe tre të pandehurit e tjerë të shpallen edhe në shkallën e dytë si kriminelë lufte, unë do të thoja se lufta e NATO-s në '99-ën është e justifikuar dhe në qoftë se ka ndonjë gjë për të cilën duhet të kritikohet është se kjo ndërhyrje u bë me vonesë sepse po të ishte ndërhyrë më herët do të kishin shpëtuar me mijëra jetë dhe nuk do të kishin pasur refugjatë në Ballkan, në Bosnjë, në Kosovë dhe gjithashtu do të kishin shpëtuar dhe jetë serbësh. Ndërhyrja e NATO-s mbetet ndërhyrja më e drejtë dhe më e duhur dhe perëndimi duhet të jetë krenar për këtë. Nuk mund të jetë i krenar për atë që ndodhi në korrik dhe në gusht të '99-ës nën vështirimin dhe nën sytë e qindra qytetarëve të KFOR-it kur kanë ndodhur masakra kundër serbëve dhe të popullsisë rome. Megjithatë e gjithë ndërhyrja në përgjithësi ishte e justifikuar dhe mbetet e justifikuar.

Armela Ferko: Pra thënë këtë, ka një lloj pasaje që e lë gjithsesi ky proces simbolikisht, politikisht ose a hapi ai një rrugë të rrezikshme që mund të shkohet dhe përtej këtyre komandantëve të UÇK-së. Ndërkohë që në anën tjetër popullsia në Kosovë, qytetarët e Kosovës pret ende që të bëhet drejtësi për gjithë ato masakra që u përmendën. Kemi parë sot dëshmitarë të shumtë, gra të cilat kanë qenë viktimat të represionit, përdhunimit që kanë qenë me lot në sy ndërsa dëgjojnë që flitej për krime lufte dhe mbi të gjitha dua që ta përmendni pak këtë, në emër të popullit të Kosovës, ë? Në nisje të frazës së gjyqtarit Smith ishte 'në emër të popullit të Kosovës'.

Michael Martens: Sikurse e dini, dhomat speciale në Hagë janë pjesë zyrtare e sistemit të drejtësisë së Kosovës sepse në këtë mënyrë është iniciuar ky organizim i gjyqësorit nga Hashim Thaçi kur ishte në pushtet. Mund të tingëllojë një situatë e çuditshme kur një gjyqtar i huaj flet në emër të popullit të Kosovës, nuk është pjesë e atij populli dhe mund ta dëgjonit madje edhe gjatë vendimit që nuk arrinte dot të shpëltonte qartë vendlindjet e të pandehurve. Por e kuptojmë se pse ky gjyq ndodhi në Hagë sepse u mendua e pamundur që të zhvillohej në territorin e Kosovës. Kur flasim për viktimat, është e rëndësishme që të mbajmë mend masakrat e serbëve kundër shqiptarëve në Kosovë. Por të mos harrojmë që në ditë të tilla ne nuk duhet të mendojmë vetëm për të akuzuarit, por duhet të mendojmë për ata persona të cilët ranë viktimat në kampe. Këta persona ishin serbë por ishin gjithashtu edhe shqiptarë. Shqiptarët ishin mbështetës të Ibrahim Rugovës dhe në shumë raste janë arrestuar, janë torturuar, disa prej tyre edhe janë kërcënuar apo vranë. Ka ardhur momenti të rëfeket historia e këtyre personave, të mbijetuarve apo të atyre të cilët humbën të afërmit e tyre, që u vranë ose u shkatërruan në kampet e UÇK-së vetëm sepse ishin përkrahës të Ibrahim Rugovës dhe më pas u shpallën si armiq dhe tradhtarë. Këto histori duhet t'i rrefehen botës.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator22:25

[“Pse Vuçiç nuk është thirrur në Hagë?” Walker: I mërzitur e zhgënjyer nga BE, vendosi shenjën e barazimit me tmerret serbe](#)

Një moment të keq për Kosovën, të gjithë Ballkanin dhe Europën e ka konsideruar ish-shefi i misionit të OSBE-së n&e...

KOSOVA 16 Shtator22:10

[Djali i Hashim Thaçit reagon pas dënimit të të atit me 25 vjet burg: Kjo betejë nuk ka mbaruar](#)

Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka reaguar pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Ko...

KOSOVA 16 Shtator22:05

[Si apelohe](#)

Ekipet mbrojtëse të ish-eporëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar se do të apelojn&...

KOSOVA 16 Shtator21:37

[“Duke luftuar për Kosovën”, Rita Ora shpërndan të dhënat e viktimave të luftës së Kosovës](#)

Mes figurave të shumta të njohura për vendimin e aktgjykimimit ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së, kanë reaguar edhe ...

KOSOVA 16 Shtator21:34

[Kurbani i fundit për Kosovën](#)

Nga Lutfi Dervishi: Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë Kur Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi mor...

KOSOVA 16 Shtator21:30

[‘Liria ka emër’/ Dua Lipa reagon ndaj vendimit në Hagë](#)

Artistja shqiptare Dua Lipa, ka reaguar ndaj vendimit të Hagë për ish-krerët e UÇK-së Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup...

KOSOVA 16 Shtator21:00

[Franca pas verdiktit të Hagës: Vendimi mund të apelohe](#)

Pas aktgjykimimit dënues të Dhomave të Specializuara ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, Franca ka pë...

KOSOVA 16 Shtator20:52

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Gjenerali i NATO-s reagon ndaj Hagës: Thaçi nuk është kriminel për t’u dënuar](#)

Ish-gjenerali i NATO-s, Wesley Clark deklaroi se ishte i shokuar dhe i zemëruar për vendimin e Gjykatës së Hagës, e cila dënoi me ...

KOSOVA 16 Shtator20:49

[Deputeti i LDK-së: Sonte do ta votonim Hashim Thačin për President me 100 vota](#)

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ermal Sadiku, ka reaguar pas aktgjykimit të sotëm të Dhomave të Specializuara në H...

KOSOVA 16 Shtator20:40

['Mos e lejo o Jakup Krasniqi se do jemi pishman' fjalimi epik i Rexhep Selimit kundër Gjykatës Speciale që sot i dënoi të dy me 38 vite burg](#)

Njëmbëdhjetë vite më parë, në sallën e Kuvendit të Kosovës zhvillohej një nga debatet më të forta po...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, nd&eu...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

KOSOVA 16 Shtator

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafigas, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.